



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më .04.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
(RTSH) PËR VITIN 2018**

I. Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim Raportin vjetor të veprimtarisë së RTSH-së për vitin 2018 në mbledhjet e tij të datave 15 dhe 16 prill 2019.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 15 prill për të bërë prezantimin e raportit vjetor, si dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin Kryetari i KDRTSH-së z. Kristaq Traja, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, z. Thoma Gëllçi, dhe Kryetari i Bordit të Administrimit, z. Pandi Madhi.

Komisioni caktoi relator për këtë çështje zotin Musa Ulqini.

II. Baza ligjore

Bazuar në nenin 102, pika 18, të ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, Këshilli Drejtues i RTSH-së paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin vjetor të veprimtarisë së RTSH-së për vitin 2018.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1, e Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi

Në përmbushje të njëres prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën e paraqet në seancë plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të RTSH-së për vitin 2018, si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2019.

IV. Diskutimi në Komision

Në paraqitjen e veprimtarisë së RTSH -së, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së në fjalën e tij paraqiti drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm, si dhe prioritetet kryesore të tij për vitin 2019.

Relatori i caktuar nga Komisioni për këtë çështje, z. Musa Ulqini, paraqiti një informacion me vlerësimet e tij për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni, si dhe disa rekomandime për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim.

Raporti vjetor pasqyron në mënyrë të detajuar të gjithë aktivitetin e RTSH-së, përfshi analizën e Drejtorisë së Lajmeve dhe Emisioneve Tematike, raportin e Njesisë Teknike, raportet e departamenteve të tjera të institucionit, raportin e hollësishëm ekonomiko- financiar, informacion për proceset gjyqësore ku RTSH është palë, si dhe objektivat për vitin 2019.

Veprimtaria e RTSH-së gjatë vitit 2018 rezulton në progres të realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer qytetarëve, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare. Për vitin 2018, veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare, si dhe për të realizuar programe cilësore, të cilat pasqyrojnë të dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare.

Anëtarët e Komisionit kërkuar nga përfaqësuesit e RTSH-së informacione shtesë për fondin e të ardhurave, nivelin e arkëtimit të tarifës së aparatit marrës të sinjalit televiziv, si dhe mbulimin e sinjalit të RTSH-së në qarqe dhe zona të ndryshme të vendit.

Gjatë diskutimeve, anëtarët e Komisionit vlerësuan punën e kryer nga RTSH-ja gjatë vitit 2018, e cila ka rezultuar edhe në përmbushje të kërkesave të rezolutës së mëparshme të

Kuvendit, si dhe të vlerësimeve të organizmave ndërkombëtarë. Gjithashtu, Komisioni shprehu angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me RTSH-në, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale ndaj këtij institucioni.

Në mbledhjen e datës 16 prill, Komisioni u mbledh për të shqyrtuar draftin e projektrezolutës së përgatitur nga Relatori, i cili pasqyron të dhënat e raportuara për aktivitetin e RTSH-së, si dhe çështjet e diskutuara në seancën dëgjimore të datës 15 prill. Projektrezoluta paraqet vlerësimet për veprimtarinë e RTSH-së gjatë vitit 2018, si dhe rekomandimet përkatëse për vitin 2019.

V. Përfundime

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni miratoi projektrezolutën me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqit për miratim Kuvendit, sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

Musa ULQINI

Milva EKONOMI

Relator

Nënkryetar